- 2.16 “Termet e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

## Neni 3 Hartimi i Kontratës

- 3.3 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.4 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

## Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.4 Autortiteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit për Prokurimin Publik.
- 4.5 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

4.6 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

#### Neni 5 Informacioni Konfidencial

5.3 Kontraktuesi dhe Autoriteti Përgjegjës duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.4 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

#### Neni 6 Prona Intelektuale

6.5 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

6.6 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

6.7 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.

6.8 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje më ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

7.7 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale te pranuar në përgjithsi.

7.8 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

7.9 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

7.10 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetences së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

7.11 Gjatë zbatimit të kontratës, kontraktuesi duhet të koordinojë me kontraktorët e tjerë zbatues në vendodhjen e shërbimeve sipas metodës që do të propozojë me qëllim ecurine dhe zbatimin brenda afatit të kontratës.

7.12 Kontraktori duhet të paraqesë planin e koordinimit tek drejtuesi i projektit për shqyrtim dhe miratin e tij.

**Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit**

8.4 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.

8.5 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.

8.6 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

**Neni 9 Specifikime dhe Skicime**

9.3 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatiti të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuar dhe të njohura në përgjithsi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marri parasysh standartet më të fundit.

9.4 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë pregatitur në bazë asnjënjëse përse i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

**Neni 10 Lejet dhe Liçensat**

10.2 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

**Neni 11 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor**

11.5 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Kontraktuesit.

11.6 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.

11.7 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.

11.8 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkak i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.

**Neni 12 Vendndodhja**

12.3 Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuar në kontratë.

12.4 Në se nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

**Neni 13 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

13.3 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

13.4 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithsi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

**Neni 14 Çmimi i Kontratës**

14.2 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në ofertën e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

**Neni 15 Afatet e Pagesës**

- 15.6 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.
- 15.7 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.
- 15.8 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.
- 15.9 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendrike nga dita që janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.
- 15.10 Data e pagesës do të jete dita që fondet debitohej nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

#### Neni 16 Vonesa në Bërjen e Pagesës

Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Përgjegjës, megjithëse kontraktuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

#### Neni 17 Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

- 17.2 Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës..

#### Neni 18 Forca Madhore

- 18.4 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.
- 18.5 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- 18.6 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

#### Neni 19 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

- 19.6 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
- 19.7 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.

- 19.8 Autoriteti Kontraktues mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 19.9 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
- 19.10 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Përgjegjës me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Përgjegjës duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Përgjegjës është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Përgjegjës dhe Kontraktuesi.

Neni 20 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

- 20.2 Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:
- d) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
  - e) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates..
  - f) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates...

Neni 21 Negociatat dhe Amendamentet

- 21.4 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.
- 21.5 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Përgjegjës.
- 21.6 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 22 Ndryshimi i Porosisë

- 22.2 Autoriteti Përgjegjës rezervon të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

Neni 23 Ndërprerja për Mosplotësim

- 23.3 Autoriteti Përgjegjës mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
- c) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
  - d) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
- 23.4 Autoriteti Përgjegjës duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 24 Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

- 24.3 Autoriteti Përgjegjës mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paafhtë të paguajë.
- 24.4 Autoriteti Përgjegjës duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.
- Neni 25 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik
- 25.4 Autoriteti Përgjegjës mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
- 25.5 Autoriteti Përgjegjës duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.
- 25.6 Autoriteti Përgjegjës duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.
- Neni 26 Nënkontrata
- 26.6 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrëveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë
- 26.7 Kontraktori nuk duhet të nënkontraktojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Përgjegjës dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Përgjegjës për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nënkontraktorit. Autoriteti Përgjegjës duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.
- 26.8 Cdo nënkontraktor duhet të ketë të drejtë të marrë pjesë në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për shërbimet që do të furnizojë.
- 26.9 Kur Kontraktuesi ka ndër mend të realizojë një pjesë të punimeve me nën-kontraktues, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumentave të tenderit, gjithë dokumentacionin e kërkuar për nënkontraktuesin si dhe punimet konkrete që do të japë me nënsipermarrje.
- 26.10 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pamvarësisht nga sjellja e nënkontraktorit.
- Neni 27 Transferimi i të Drejtave
- 31.2 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Përgjegjës.
- Neni 28 Sigurimi i Kontrates
- 28.4 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Përgjegjës sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e kërkuar.
- 28.5 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Përgjegjës si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 28.6 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.
- Neni 29 Baza Ligjore
- 29.2 Kontrata do të rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.
- Neni 30 Zgjidhja e Mosmarrveshjeve
- 30.3 Autoriteti Përgjegjës dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

30.4 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 31 Përfaqësimi i Palëve

31.4 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

31.5 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

31.6 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 32 Lajmërimet

32.3 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetër sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

32.4 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 33 Llogaritja e Afateve

33.2 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

Shtojca 22

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës ]

## KUSHTET E VEÇANTA

Shërbimet

Kushtet e veçanta të Kontratës hartohen në përputhje me objektin konkret të kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojnë Kushtet e veçanta të kontratës.

Neni 1 Përkufizime

1.3 Autoriteti Përgjegjës është Fondi Shqiptar i Zhvillimit

1.4 Kontraktuesi është \_\_\_\_\_

Neni 2 Sigurimi i kontratës

2.3 Sigurimi i kontratës në shumën prej 15 % të vlerës së ofertës duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

2.4 Sigurimi i Kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm: Pas plotësimit të gjithë detyrimeve kontraktore nga ana e operatorit ekonomik

Neni 3 Fillimi i Kontratës

3.2 Zbatimi i kontratës duhet të fillojë më \_\_\_\_\_. Nëse nuk është specifikuar, zbatimi do të fillojë në datën që Kontraktuesi nënshkruan formularin e kontratës.

Neni 4 Vendndodhja e Shërbimeve

4.2 Shërbimet do të kryhen në: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



Neni 5 Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Përgjegjës

5.2 Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit të kontratës, Autoriteti Përgjegjës duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Neni 6 Kërkesat e Raportimit

6.2 Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Përgjegjës sipas formularit të mëposhtëm: Sipas Termave të referencës

Neni 7 Siguracioni i Përgjegjësive Profesionale

7.2 Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Përgjegjës me prova për siguracionin e përgjegjësive profesionale me shumë minimale si vijon: *100% të vlerës së Kontratës*

Neni 8 Kushtet e Pagesës

8.2 Pagesa për Shërbimet duhet bërë sipas skedarit të mëposhtëm: *5% e vlerës së Kontratës do të mbahet deri në përfundim të afatit të garancisë së punimeve.*

\_\_\_\_\_

8.4 Çdo pagesë e skeduar duhet bërë brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga data e arritjes së marrveshjes për pagesën ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim për pagesë cilado që të jetë më vonë. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

8.5 Monedha e pagesës do të jetë \_\_\_\_\_. Nëse është lënë e paplotësuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

Neni 9 Pagesa Paraprake

9.2 Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

Neni 10 Zbritja e garancisë së kontratës

10.1 Garancia mbetet e pandryshuar.

Neni 11 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

10.1 Në kushtet e përgjithshme të kontratës janë përcaktuar rastet e likuidimit të dëmeve për dorëzimin e vonuar.

10.2 Në vecanti për pikat e mëposhtme do të aplikohen penalitete si më poshte:

\_\_\_\_\_

Shtojca 23

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]  
[ Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]

FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

[Data\_\_\_\_\_]

Për : [Emri dhe adresa e autoritetit Përgjegjës]

Në emer të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

Procedura e prokurimit (nëse zbatohet): [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: (objekti)

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimit Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [emri i ofertuesit të përcaktuar fitues] t'i jetë akorduar kontrata, ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të përcaktuar fitues] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve] në një shumë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [emri i autoritetit përgjegjës]

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos-përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

Shtojca 24

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës]

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR

Seksioni 1 Autoriteti Përgjegjës

## 1.1 Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës

Emri \_\_\_\_\_  
 Adresa \_\_\_\_\_  
 Tel/Fax \_\_\_\_\_  
 E-mail \_\_\_\_\_  
 Adresa në Internet \_\_\_\_\_

## 1.2 Lloji i autoritetit përgjegjës:

Institucion Qëndror	<input type="checkbox"/>	Institucion i Pavarur	<input type="checkbox"/>
Njesite e Qeverisjes Vendore	<input type="checkbox"/>	Tjetër	<input type="checkbox"/>

Seksioni 2 Objekti i Kontratës

2.1 Numri i referencës së procedurës/lotit \_\_\_\_\_

## 2.2 Lloji i “Kontratave Publike për Shërbime”

Konkurs Projektimi	<input type="checkbox"/>	Shërbime Konsulence	<input type="checkbox"/>	Shërbime të tjera	<input type="checkbox"/>
--------------------	--------------------------	---------------------	--------------------------	-------------------	--------------------------

## 2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuader

	Po	<input type="checkbox"/>	Jo	<input type="checkbox"/>
--	----	--------------------------	----	--------------------------

Nëse Po, lloji i Marrëveshjes Kuadër

Me 1 Operator Ekonomik Me disa operatorë ekonomikë 

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara

Po	<input type="checkbox"/>	Jo	<input type="checkbox"/>
----	--------------------------	----	--------------------------

## 2.4 Përshkrim i shkurtër i kontratës

1. Fondi limit/ vlera e përafërt e kontratës \_\_\_\_\_

2. Burimi i Financimit \_\_\_\_\_

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër \_\_\_\_\_

2.5 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në muaj    ose ditë

ose

duke filluar nga   /   /     me përfundim në   /   /

2.6 Ndarja në LOTE:

Po  Jo

Nëse Po, numri i LOTEVE:

2.7 Opsionet:

Numri i rinovimeve të mundshme(nëse ka):

ose: nga   në

2.8 Kontrate me nenkontraktim:

Po  Jo

Seksioni 3 Procedura

3.1 Lloji i procedurës:

E kufizuar  
në kuadër të procesit  
të rindërtimit

3.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Oferta ekonomikisht  më e favorshme

3.3 Numri i ofertave të dorëzuara:

Numri i ofertave të rregullta:

3.4. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombetare e Shoqërisë së Informacionit:

Po  Jo

3.5. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standartet janë të paaplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombetare e Shoqërisë së Informacionit

Po  Jo

Seksioni 4 Informacion mbi kontratën

4.1 Numri i Kontratës: \_\_\_\_\_ Data e Kontratës   /   /

## 4.2 Emri dhe adresa e kontraktorit

Emri \_\_\_\_\_  
 Adresa \_\_\_\_\_  
 Tel/Fax \_\_\_\_\_  
 E-mail \_\_\_\_\_  
 Adresa e Internetit \_\_\_\_\_

## 4.2.1 Emri dhe adresa e nenkontraktorit/eve

Emri \_\_\_\_\_  
 Adresa \_\_\_\_\_  
 Tel/Fax \_\_\_\_\_  
 E-mail \_\_\_\_\_  
 Faqja e Internetit \_\_\_\_\_

## 4.3 Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin):

Vlera \_\_\_\_\_ (pa TVSH) Monedha \_\_\_\_\_  
 Vlera \_\_\_\_\_ (me TVSH) Monedha \_\_\_\_\_

## 4.3.1 Vlera totale e nenkontraktimit : \_\_\_\_\_

Vlera \_\_\_\_\_ (pa TVSH) Monedha \_\_\_\_\_  
 Vlera \_\_\_\_\_ (me TVSH) Monedha \_\_\_\_\_

## 4.4 Informacione shtesë

\_\_\_\_\_

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi □□/□□/□□□□

Shtojca 25

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike]

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR PËR PUBLIKIM

1. Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës

Emri \_\_\_\_\_  
 Adresa \_\_\_\_\_  
 Tel/Fax \_\_\_\_\_  
 E-mail \_\_\_\_\_  
 Faqja në Internet \_\_\_\_\_

2. Lloji i procedurës: \_\_\_\_\_

3. Numri i referencës së procedurës/lotit \_\_\_\_\_

4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër \_\_\_\_\_

5. Fondi limit \_\_\_\_\_

6. Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin):

Vlera \_\_\_\_\_ (me TVSH) Monedha \_\_\_\_\_

Vlera e nenkontraktimit \_\_\_\_\_ me Tvsh Monedha \_\_\_\_\_

7. Data e lidhjes së kontratës \_\_\_\_\_

8. Emri dhe adresa e kontraktorit /nenkontraktorit

Emri \_\_\_\_\_  
 Adresa \_\_\_\_\_  
 Nr. NIPT \_\_\_\_\_

Shtojca 26

FORMULAR PËR NJOFTIMIN E ANULIMIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT

1. Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës

Emri \_\_\_\_\_  
 Adresa \_\_\_\_\_  
 Tel/Fax \_\_\_\_\_  
 E-mail \_\_\_\_\_  
 Faqja në Internet \_\_\_\_\_

1. Lloji i procedurës: \_\_\_\_\_

2. Numri i Referencës: \_\_\_\_\_

3. Objekti i kontratës \_\_\_\_\_

4. Fondi limit \_\_\_\_\_

5. Arsyet e Anulimit:

Bazuar në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 24, pika 1:

- a) ;
- b) ;
- c) ;
- ç) ;
- d) ;
- dh) ;

Etj. \_\_\_\_\_

6. Informacione shtesë

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi \_

Shtojca 27.

## FORMULARI I ANKESËS PRANE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Komisionit të Prokurimit Publik 

Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në bashkëpunim, në bashkim shoqëror).*

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni) \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

Qyteti \_\_\_\_\_ Shteti \_\_\_\_\_ Kodi Postar/Kodi Zip \_\_\_\_\_

Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës) \_\_\_\_\_ Nr. Faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës) \_\_\_\_\_

E-mail \_\_\_\_\_

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni) \_\_\_\_\_

Firma e zyrtarit të autorizuar \_\_\_\_\_ Data (viti/muaji/dita) \_\_\_\_\_

Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës) \_\_\_\_\_ Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës) \_\_\_\_\_

Seksioni II. Informacion për Procedurën

1. Numër Identifikimi

*Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentat e tenderit, duke përfshirë llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë (psh, Kërkesë për Propozime(KP), Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar(PK), Procedurë me Negociim(PN), Shërbim Konsulente (SHK), Konkurs Projektimi (KP).*

---

2. Autoriteti Përgjegjës

*Emri i autoritetit përgjegjës që administron procesin e prokurimit.*

---

3. Vlera e Përlllogaritur e Prokurimit

*Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)*

---

4. Objekti i Kontratës

*Përshkrim i shkurtër i shërbimeve që blihen.*

---

5. Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës

*Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.*

---

Data (viti/muaji/dita)

6. Data e Përcaktimit të Kontratës Fituese

---

Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza Ligjore e Ankesës

*(shkruani shkeljen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumenta, etj)*

---



## 2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve

*Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet përkatëse të dokumentave të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.*

## 3. Lista e Shtojcave

*Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e tenderit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj . Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për prokurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Nr. Faks:

E-mail:

Nenshkrimi dhe Vula e ankuesit

Shtojca 28

**DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR  
( KU TE GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA)  
PER SHËRBIME**

[Përdorimi i këtij draft marrëveshje është detyruese për të gjitha Autoritetet Përgjegjëse që do të përdorin marrëveshjen kuadër)

Nr \_\_\_\_

DATA:

Kjo marrëveshje lidhet [data], midis [emri dhe adresa e Autoritetit Përgjegjës] tani e tutje të referuar si “Autoriteti Përgjegjës” dhe [emri dhe adresa e Kontraktuesit] të përfaqësuar nga [përfaqësuesi], tani e tutje i quajtur si “Kontraktuesi”.

Kontraktori, me datë [data] bie dakord të të realizojë shërbimet, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

– Këtë marrëveshje

- Formulari i Deklarimit të Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Specifikimet teknike/ termat e references
- Formulari i çmimit të ofertës
- Etj

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësajmarrëveshje.

## Neni 1 Objekti

- 1.1 Objekti i marrëveshjes kuadër është të përcaktojë kushtet, përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat për dorëzimin e shërbimeve në vijim.  
[përshkrimi i përgjithshëm]
- 1.2 Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatorët ekonomikë, palë në marreveshje.
- 1.3 Sasitë e parashikuara, janë vetëm sasi orientuese dhe nuk e kushtëzojnë Autoritetin Përgjegjës për t'i blerë ato. Autoriteti Përgjegjës ka të drejtë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parashikuara
- 1.4 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe nuk do t'i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti Përgjegjës vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të specifikuar dhe/ose në rast se autoriteti përgjegjës vendos të mos blejë asnjë nga këto sasi për disa artikuj.
- 1.5 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër:

## Neni 2 Çmimi

- 2.1 Çmimet për njësi për shërbime janë treguar në Formularin e Çmimit të Ofertës.
- 2.2 Çmimet e njësisive duhet të jenë fikse dhe nuk duhet t'i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marreveshje kuadër,

## Neni 3: Zgjatja e Afatit të marrëveshjes kuadër

- 3.1 Autoriteti Përgjegjës do të jetë dakord për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.
- 3.2 Autoriteti Përgjegjës, mund të jetë dakord për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë..
- 3.3 Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Përgjegjës me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar për zgjatjen e afatit. Autoriteti Përgjegjës duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Përgjegjës është dakord me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të marrëveshjes të nënshkruar nga Autoriteti Përgjegjës dhe kontraktori.

## Neni 4: Modifikimi i marrëveshjes kuadër

- 4.1. Marrëveshja kuadër mund të modifikohet pa zhvilluar një procedurë të re prokurimi në rastet si më poshtë:
  - a) Kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti Përgjegjës dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e marrëveshjes kuadër.

b) Vlera e totale e modifikimeve të marrëveshjes kuadër nuk duhet të tejkalojë 20% vlerës së marrëveshjes kuadër.

Neni 5: Zgjidhja e marrëveshjes kuadër

5.1. Autoriteti Përgjegjës zgjidh marrëveshjen kuadër gjatë kohëzgjatjes së saj, në rastet kur:

- a) marrëveshja kuadër duhet të modifikohet në mënyrë thelbësore, gjë e cila lind detyrimin për zhvillimin e një procedure të re të prokurimit publik;
- b) nëse ka një vendim të formës së prerë për përjashtimin e kontraktorit nga procedurat e prokurimit publik, për arsye që nëse do ishin të njohura nga njësa zbatuese gjatë zhvillimit të procedurës konkrete, do të çonin në skualifikimin e këtij operatori ekonomik;
- c) marrëveshja kuadër nuk duhet t'i ishte dhënë kontraktorit, për shkak të shkeljeve të rënda të ligjit, të cilat rrjedhin nga një vendim gjyqësor i formës së prerë, të dhënë nga një gjykatë kompetente

Nënshkrimet dhe Datat	
Për Kontraktuesin	Për Autoritetin Kontraktues
Emri:	Emri:
Pozita:	Pozita:
Nënshkrimi	Nënshkrimi:
:	
Data:	Data:
Vula:	Vula:

Shtojca 29

**DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR  
( KU JO TË GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA)  
PËR SHËRBIME**

Emri i Autoritetit Përgjegjës,

Dhe

Emri i Kontraktuesit

Bien dakord si vijon:

Të nënshkruajnë këtë marrëveshje kuadër për Kryerjen e: < vendosni titullin > me numrin identifikues : <vendosni Numrin e Prokurimit>

Neni 1 Objekti

1.4 Objekti i kësaj marrëveshje kuadër është të vendosë rregullat për kontratat të cilat do të lidhen përmes procesit të konkursit vetëm ndërmjet operatorëve ekonomike që janë palë e kësaj marrëveshje kuadër.

1.5 Kjo marrëveshje kuadër nuk është një kontratë në vete por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen në bazë të saj.

1.6 Kontraktuesi është vetëm një nga palët e marrëveshjes kuadër.

## Neni 2 Detyrimet e Palëve

2.1 Autoriteti Përgjegjës, palë në këtë marrëveshje, do t'i dërgojë kontraktuesit "Ftesën për Ofertë" kurdo që paraqitet nevoja për shërbime.

2.2 Kontraktuesi, detyrohet të dorëzojë një ofertë kurdo që kërkohet nga Autoriteti Përgjegjës.

## Neni 3 Kontratat në zbatim të marrëveshjes kuadër

3.1 Kontratat do të nënshkruhen vetëm pas procesit të konkursit.

## Neni 4 Procesi konkurrencës në marrëveshjen kuadër

4.1 Procesi i konkursit do të kryhet me të gjithë operatorët ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër, kurdoherë që paraqitet nevoja për shërbime për Autoritetin/et Përgjegjëse.

4.3 Autoriteti Përgjegjës do të ri-hapë konkursin në bazë të kushteve të njëjta ose të kushteve të tjera të vendosura në ftesën për ofertë, sipas përcaktimeve në dokumentet e tenderit.

4.3 Kurdoherë që paraqitet nevoja për shërbim Autoriteti Përgjegjës duhet të përgatisë Ftesat për Oferte dhe t'ua dërgojë të gjithë operatorëve ekonomike, palë në marrëveshjen kuadër. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në Ftesën për Ofertë

## Neni 5 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër:

---

### Neni 6: Zgjatja e Afatit të marrëveshjes kuadër

6.1 Autoriteti Përgjegjës do të jetë dakord për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

6.2 Autoriteti Përgjegjës, mund të jetë dakord për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë..

6.3 Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Përgjegjës me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar për zgjatjen e afatit. Autoriteti Përgjegjës duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Përgjegjës është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të marrëveshjes të nënshkruar nga Autoriteti Përgjegjës dhe kontraktori.

### Neni 7: Modifikimi i marrëveshjes kuadër

7.1. Marrëveshja kuadër mund të modifikohet pa zhvilluar një procedurë të re prokurimi në rastet si më poshtë:

- a) Kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti përgjegjës dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e marrëveshjes kuadër.
- b) Vlera e totale e modifikimeve të marrëveshjes kuadër nuk duhet të tejkalojë 20% vlerës së marrëveshjes kuadër.

Neni 8: Zgjidhja e marrëveshjes kuadër

8.1. Autoriteti Përgjegjës zgjidh marrëveshjen kuadër gjatë kohëzgjatjes së saj, në rastet kur:

- a) marrëveshja kuadër duhet të modifikohet në mënyrë thelbësore, gjë e cila lind detyrimin për zhvillimin e një procedure të re të prokurimit publik;
- b) nëse ka një vendim të formës së prerë për përjashtimin e kontraktorit nga procedurat e prokurimit publik, për arsye që nëse do ishin të njohura nga njësa zbatuese gjatë zhvillimit të procedurës konkrete, do të çonin në skualifikimin e këtij operatori ekonomik;
- c) marrëveshja kuadër nuk duhet t'i ishte dhënë kontraktorit, për shkak të shkeljeve të rënda të ligjit, të cilat rrjedhin nga një vendim gjyqësor i formës së prerë, të dhënë nga një gjykatë kompetente.

Nënshkrimet dhe datat

Për Kontraktuesin

Për Autoritetin Përgjegjës

Emri :

Emri:

Pozita:

Pozita:

Nënshkrimi

Nënshkrim

:

:

Data:

Data:

Vula:

Vula:

# **KONTRATA TË NËNSHKRUARA PËR PROCEDURA TË KUFIZUARA**

## **AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri                      Autoriteti Rrugor Shqiptar  
Adresa                    Rr. Sami Frashëri Nr. 33 Tiranë  
Tel/Fax                    04/2 234487  
E-mail                    info.arrsh@arrsh.gov.al  
Faqja në Internet      [www.arrsh.gov.al](http://www.arrsh.gov.al)

2. Lloji i procedurës:    Procedure e hapur

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër:    «Rindertim i Ures se Tapizes» (procedure ne kuader te rindertimit)

4. Numri i referencës së procedurës/loti:                      REF- 67335-07-29-2020

5. Fondi limit:                      151.539.896,39 Lekë

6. Vlera totale përfundimtare e kontratës (*duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin*):

Vlera                      180.454.949,4                      me Tvsh                      Monedha                      lekë

Vlera e nenkontaktimit \_\_\_\_\_ me Tvsh                      Monedha \_\_\_\_\_

7. Data e lidhjes së kontratës 22.09.2020

8. Emri dhe adresa e kontraktorit/nenkontraktimit

Emri                      “G.P.G COMPANY” & ”NG STRUCTURES”  
Adresa                    Fier Lushnje LUSHNJE Lagjja 18 Tetori, godine 1 kateshe, tek nyja e prodhimit  
Asfalto-Betonit, prane Rotondos se Plukut.  
Nr. NIPT                    J64324443V /L79326502O